

LIGJ
Nr.7694, datë 6.4.1993

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES PËR DHËNIEN E KREDISË PËR ZHVILLIM
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS PËR ZHVILLIMIN
NDËRKOMBËTAR"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e "Marrëveshjes për dhënie të kredisë për zhvillim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës për Zhvillimin Ndërkombëtar (IDA - Banka Botërore)", nënshkruar në Uashington më 2 mars 1993 për mbështetje të projektit "Për lehtësimin e varfërisë në zonat rurale" me një vlefë prej 1.800.000 SDR (e barasvlefshme me 2.400.000 dollarë amerikanë).

Neni 2

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.511, datë 16.4.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Sali Berisha.